

Datë 30.04.2013

MENDIMI i Pakicës “ KUNDËR”

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.281, datë 30.04.2013 “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Hec Ulëz Shkopet nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga shoqëria Kurum International Sh.a” dhe Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.282, datë 30.04.2013 “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2, nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit nga shoqëria Kurum International Sh.a” kam mbajtur qëndrimin KUNDER me arsyetimin e mëposhtëm.

I. Tregu i gjenerimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike, ka qënë objekt i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit të Konkurrencës, disa herë, duke mbajtur një qëndrim të qartë për promovimin dhe realizimin e konkurrencës në këtë treg. Qëndrimi i mbajtur mbi bazën e hetimit të përgjithshëm në sektorin e energjisë, pjesa e energjisë elektrike, nëpërmjet vendimit Nr. 90, Datë 07.10.2008 “**Disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike**” ka konsistuar midis të tjerash”:

- 1) Respektimi i nenit Nr. 69 të Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” për të marrë në kohë dhe para miratimit të akteve vlerësimit nga ana e Autoritetit të Konkurrencës.
- 2) Në treg duhet të funksionojë Operatori i Furnizimit me Shumicë dhe të hapet dhe/ose të rritet konkurrenca si në tregun e prodhimit ashtu dhe në tregun e furnizimit me shumicë dhe pakicë me energji.
- 3) Përfshirjen e sa më shumë biznesve si klientë dhe konsumatorë jo tariforë dhe furnizues jo tariforë.
- 4) **Miratimi i tarifave të tregëtimit të energjisë elektrike duhet bërë në mënyrë të balancuar dhe pa diskriminime**, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt kostos mesatare të ponderuar të ofertës së energjisë, duke marrë në konsideratë si koston mesatare të importit ashtu dhe të prodhimit.
- 5) Furnizuesi me shumicë dhe operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të marrin të gjitha masat për të përmbushur detyrimet e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike të lidhur me prodhuesit e vegjël. Të monitorojë furnizuesin me shumicë dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes që të marrin masat për të përmbushur detyrimet e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike lidhur me prodhuesit e vegjël. etj

Ndërsa me Vendimin Nr. 159, datë 19.11. 2010 të Komisionit të Konkurrencës”, “**Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike.**”, në funksion të rritjes së konkurrencës në tregun e prodhimit dhe furnizimit me shumicë dhe me pakicë me energji elektrike , fillimisht konstatohet se :

Në praktikë nuk është zbatuar kërkesa e modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.03.2008, sipas të cilit, Furnizuesi publik me shumicë dhe KESH-Gen duhet të jenë të ndarë financiarisht dhe funksionalisht, por në fakt ato operojnë si njësi të vetme ekonomike. Ndarja funksionale dhe financiare e furnizuesit publik me shumicë nga KESH-Gen, do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar).

Ndërsa në pjesën e “Vendimarrjes” të këtij Vendimi është Rekomanduar :

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike:

- 1.1 Ndarjen funksionale dhe financiare *reale* të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen, e cila do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar) për të kryer transaksione konkurruese dhe është në zbatim të modelit të tregut.
- 1.2 Ndarjen financiare *reale* të “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” dhe “Furnizuesit Publik me Pakicë” në mënyrë që të operojnë si njësi të ndara financiarisht pasi këto segmente tregu janë të liberalizuara dhe është një instrument që ndikon në rritjen e konkurrencës në këtë segment të tregut.

Pra, Komisioni i Konkurrencës dhe Autoriteti i Konkurrencës në tërësi ka patur një vendimarrje të qartë jo thjesht për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive por dhe për promovimin e saj, me një synim të qartë që kjo konkurrencë të kontribuojë dhe çojë në uljen e çmimit të energjisë elektrike duke marrë në konsideratë jo vetëm koston e importit por dhe koston reale të prodhimit të energjisë elektrike në vend tij, duke realizuar çmime sa më të ulta konkurruese. **Qëndrimi im në mbledhjen e sotme Date 30.04.2013 është konform dhe në vijimësi të këtyre vendimarrjeve të Komisionit të Konkurrencës për të cilat të gjithë kemi rënë dakort më parë.**

II. Monitorimi i vendimarrjeve të Komisionit të Konkurrencës.

Nga Monitorimi i Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, lidhur rritjen e Konkurrencës në tregun e Sektorit të Energjisë Elektrike e sidomos atë të prodhimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike, rekomandimet e sipër përmendura në thelb nuk janë realizuar as nga METE dhe as nga ERE.

III. Teoria ekonomike për konkurrencën dhe efijencën Fryma dhe Gërma e Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe akteve Nenligjore .

- a) Ekonomisti i shquar për teorinë e efijencës ekonomike Vilfredo Pareto shkruan, se pëpjekjet e njeriut janë përdorur në thelb në dy mënyra: a) për prodhimin ose transformimin e mallrave ekonomike (prodhimin), b) ose përvetesimin e mallrave të prodhuar më parë nga të tjerët, (blerjen, tregëtimin e tyre). Në rastin e dhënë, përqëndrimin, përfitimin e kontrollit të HEC-eve të Ulëz Shkopetit dhe Bistrica nr 1 dhe 2, jemi para rastit të transaksionit, të tregëtimit të tyre. Hidrocentralet e

ndërtuar dhe për më tepër të rikonstruktuar kohët e fundit siç është rasti i Bistrica 1 dhe 2, kanë mundësi të pakta të rritjes së kapaciteteve pas privatizimit. Një karakteristikë tjetër e këtij transaksioni është se ai ka ndodhur në një treg të rregulluar.

b) Metodatat kryesore të rregullimit të çmimit në një treg të rregulluar sipas teorisë ekonomike janë:

1. 1. Cost-Plus Regulation

Setting a regulated price that a firm is allowed to charge by first calculating its costs of production (allowing for a normal level of profit) and then setting the price to cover that cost plus a little bit of profit amount" (Rregullimi i kosto plus fitim normal

Vendosjen e një çmimi të rregulluar që një firmë mund ta arrijë duke llogaritur fillimisht koston e prodhimit (e duke lejuar për një nivel normal të fitimit) dhe pastaj përcaktimin e çmimit për të mbuluar këtë kosto të shtuar të fitimit.)

2. Metoda e dytë është Price Cap Regulation

The regulator sets a price that the regulated firm can charge that extends out several years in the future. If the firm can cut cost by more than predicted, then it can earn additional profits. (Rregullimi i çmimit kapele Rregullatori vendos një çmim të cilin mund ta aplikojë në mënyrë të rregulluar, i cili tejkalon vitin pasardhës. Nëse ndërmarrja ul kostot më tepër nga ç'është parashikuar atëherë mund të sigurojë fitime më të mëdha.

Sidoqoftë gjatë zbatimit të këtyre metodave po sipas teorisë ekonomike edhe në vendet me ekonomi të zhvilluar, ekziston potencialisht sipas teorisë ekonomike ajo që quhet Regulatory Capture The danger that regulators will believe their job is to protect industry profits and workers rather than competition and consumer (Rreziku i kapjes së rregullatorit.

Rregullatori beson se ka si detyrë të mbrojë fitimet e industrisë dhe punonjësit e saj dhe jo konkurrencën dhe konsumatorin.)

Ky rrezik që sipas teorisë ekonomike nuk është vetë potencial por real qoftë për vendet e zhvilluara, por aq më tepër për vendin tonë ku praktika rregullatore nuk ka shumë kohë.. Mjafton të mbajmë parasysh se ndërsa një nga rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës ka qënë :**“Miratimi i tarifave të tregëtimit të energjisë elektrike duhet bërë në mënyrë të balancuar dhe pa diskriminime, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt kostos mesatare të ponderuar të ofertës së energjisë, duke marrë në konsideratë si koston mesatare të importit ashtu dhe të prodhimit “**, nuk janë marrë në konsideratë

Në fakt për hidrocentralet private apo ato me koncesion nuk zbatohet e njëjta metodologji me ato të hidrocentraleve publike për përcaktimin e tarifave. Për këto të fundit sidoms ato me koncesion, çmimi i tyre nuk bazohet në të njëjten metodologji me ato të kaskadës së Drinit, Ulëz Shkopetit, Bistrica nr 1 dhe 2.

Për rrjedhojë çmimi i hidrocentraleve me koncesion rezulton të jetë sa ose më i lartë se sa importi i energjisë elektrike. Mjafton të mbahet parasysh se në vitin 2004 çmimi i energjisë elektrike me koncesion ishte 4.21 lek/kw, dhe pas vitit 2008- të e në vazhdim për për hec et e reja me fuqi të instaluar 15 MW ai arriti 9.3lek /kwh, kur tarifa e

prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Bistrica 1, 2 sh.a për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 - 2014), ishte parashikuar 2.2 leke/kWh dhe për Ulëz Shkopet 2.72 lek/kwh . Të dy këta operatorë për vitin 2012 kanë dalë me fitim normal.

Por këtu lind pyetja tjetër : A realizohet në këtë transaksioni/përqëndrim nëpërmjet përfitimit të kontrollit , alokimi me efikasitet, optimaliteti, efikasitet Pareto ?

Siç dihet efikasiteti ekonomik realizohet në kushtet e asaj situatë ku prodhimi, alokimi dhe apo konsumi mund të rritet, pa ulur prodhimin e një malli tjetër, pa rritur konsumin ose fitimin e dikujt në dëm të tjerëve.

Analiza ekonomike e këtij transaksioni/përqëndrimi e kryer nga Grupi I Punës, hartuesit e Raportit duhet të japë një përgjigje të argumentuar nëse kemi ruajtje apo rënie të efikasitetit ekonomik, nëse jemi para situatës kur “ Is it possible to make one person better off without making someone worse off “ (A është e mundur të bëhet një njeri më mirë pa bërë më keq një tjetër ?)

Në fakt siç do ta shohim dhe më poshtë, kjo analizë e Grupit të Punës që ka hartuar Raportin mungon.

Ndërkohë fryma e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës por dhe gërma e tij sidomos me kërkesat 3.5 të Formularit të Përqëndrimit e presupozojnë dhe e kërkojnë këtë analizë. Dhe janë tepër të qarta:

Në pikën 3.5 të Formularit të Përqëndrimit shkruhet:

“Përshkruani dhe argumentoni përfitimet që rezultojnë për konsumatorin pas realizimit të përqëndrimit, në mënyrë të veçantë: (a) Rënie e çmimeve.

Ndërkohe sipas pikës 9 të Formularit pala njoftuese duhet të deklarojë dhe kane deklaruar se :

Seksioni 9

Deklarimi

Njoftimi duhet të përfundojë me deklarinë e mëposhtëm që duhet të nënshkruhet nga ose në emër të të gjitha palëve njoftuese:

Pala ose palët njoftuese deklarojnë që, sipas njohurive dhe besimit të tyre të plotë, informacioni i dhënë në këtë njoftim është i vërtetë, i saktë dhe i plotë; se janë dhënë kopje të vërteta dhe të plota të dokumenteve të kërkuara nga Formulari. Të gjitha vlerësimet e dhëna identifikohen si të vërteta dhe janë vlerësimet e tyre më të mira të mbështetura mbi faktet dhe se të gjitha mendimet e shprehura janë të sinqerta.

IV Raporti i Grupit të Punës dhe Qëndrimi ndaj Tij

I. Thelbi i rekomandimit të Raportit dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme konsiston në atë se “përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit dhe forcimit të pozitës dominuese. Në fakt me këtë fjali në vetvete edhe unë jam dakort, **nëpërmjet këtij transaksioni/ privatizmi nuk kemi forcim të pozitës dominuese**. Për rrjedhojë nuk kemi as forcim të pozitës dominuese që mund të çojë nëkufizimin e konkurrencës **si produkt i forcimit të pozitës dominuese**.

Por siç evidentohet edhe në Raportin e Grupit të Punës Transaksioni/privatizimi i transferimit të 100% të HEC Ulëz Shkopet nga shoqëria Kurum International Sh.a nëpërmjet “Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve” Është subjekt i autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) dhe nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (neni 7..7.7 i Kontratës për shitjen e Aksioneve” datë 7 11.02.2013.

Ky fakt për gjykimin dhe vlerësimin tim nënkupton nje analizës të plotë dhe shumplanëshe të këtij përqëndrimi të konkurrences dhe efekteve mbi konsumatorin dhe jo simplifikimin e tij e kufizimin vetëm në atë se krijon apo nuk krijon pozitë dominuese në treg.

Pretendimi i firmës njoftuese KALO&ASSOCOATES duket mjaft simpatik “Transaksioni i nioftuar nuk shkakton **asnjë efekt** në konkurrencën e tregut përkatës në Shqipëri, për këtë arsye shpresojmë se Komisioni i Konkurrencës do ta miratojë sa më shpejt përqëndrimin në fjalë. Duke shtuar ”mbetemi në dispozicion për çdo informacion shtesë që mund të nevojitet”.

Duke ndarë të njëjtim mendim vetëm përsa i përket afatit dhe periudhës të shqyrtimit dhe miratimit sa më të shpejtë nga ana e Autoriteti të Konkurrencës të këtij përqëndrimi, duke dhënë ndihmesën time modeste për ta përsheptuar atë; për gjykimin tim mbështetur në Frymën dhe Gërmen e Ligjit Për mbrojtjen e Konkurrences dhe akteve të tij nën ligjore, kërkon dhe presupozon: a) dhënie/sigurimin e informacionit të nevojshëm për shqyrtimim dhe analizen e vlerësimin e këtij përqëndrimi; ky shqyrtim presupozon jo thjesht simplifikimin se çon apo nuk çon ai në krijimin e pozitës dominuese, por se cili është ndikimi i përqëndrimit në konkurrencën në tregun e gjenerimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike, - ndikimi i tij në eficientësinë e këtij tregu (të blerjes dhe tregëtimit të energjisë elektrike) e sidomos asaj pjese të tregut që ka të bëjë me konsumatorët tariforë -ndikimin ndaj konsumatorit(ariforë) në këtë treg, në uljen apo rritjen e çmimit si rrjedhojë e drejperdrejte e këtij transaksioni/përqëndrimi.

Lidhur me sa më sipër nga ana ime janë parashtruar dy pyetje ndaj Sekretariatit:

1. Lidhur me sasinë, çmimin dhe vlerën e energjisë elektrike të konsumuar nga ana e klientit të kualifikuar jo tarifor, para dhe pas përqëndrimit.
2. Efektin e rikonstruksionit dhe kredisë përkatse në Hidrocentralin Bistrica nr 1 dhe 2, dhe pasqyrimin tyre në vlerën e aseteve dhe bilancin e Hidrocentralit Bistrica nr 1 dhe 2 . Ku dhe si është pasqyruar kredia e marrë dhe e realizuar për këtë rikonstruksion e këtij hidrocentrali, kush do ta paguajë atë dhe cili është efekti i këtij pasqyrimi ose mospasqyrimi në bilancin e Bistrica 1 dhe 2 dhe konkurrencën në tregun e gjenerimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike?

Lidhur me pyetjen e parë Sekretariati është realizuar kërkesa ndaj Palës njoftuese me këtë përmbajtje: Ne lidhje me kontrollin e përqendrimeve me objekt "Privatizimin e Hec-eve Bistrica 1 dhe 2 dhe Ulez Shkopet nga shoqëria Kurum International Sh.a" , sipas porosive të lëna nga Komisioni i Konkurrencës dhe në bazë të nenit 55 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 :Per Mbrojtjen e Konkurrencës" , ju lutem të na vini në dispozicion nje informacion plotësues si me poshte :

1. Plani i biznesit të shoqërisë Kurum International për blerjen e HEC-eve;

2. Licencat per statusin si Klient i Kualifikuar dhe Furnizues i Kualifikuar, tregtues i energjise elektrike, per shoqerine Kurum International Sh.a;
 3. Organigrama e Grupit Kurum ne Shqiperi;
 4. Qellimi i perdorimit nga ana e shoqerise Kurum Interational Sh.a, te energjise elektrike te prodhuar nga Hec-et objekt i perqendrimit (Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2 dhe Hec Ulez Shkopet);
 5. Sqarimi i justifikimit ekonomik dhe eficensat pas realizimit te ketij transaksioni(perqendrimi).
 5. Sasia vlera dhe burimi i importit te energjise elektrike nga shoqeria Kurum International Sh.a per vitin 2012;
- Pra angazhimi i Sekretariatit ka qënë I plotë për të mundësuar një përgjigje që do të mundësonte analizën ekonomike.
- Ne datën 18.04.2013 nga pala njoftuese KALO&ASSOCOATES ka ardhur përgjigja, ku midis të tjerash thuhet:

Pergjigja : Ne lidhje me pyetjen 5, ju lutem referojuni seksionit 3.4 dhe 3.5 te Formularit te njoftimit per secilin perqendrim. Perqendrimi vjen si pasoje e qellimit te qeverise shqiptare per te privatizuar keto hidrocentrale ne baze te ligjit per privatizimin e sektoreve strategjike duke patur parasysh aksesin me te larte te shoqerive private ne burime financiare dhe kerkesat e medhaja per investime dhe mirembajtje qe kerkojne sektore te caktuar te ekonomise. “

Duke iu refruar pikës 3.4 dhe 3.5 të formularit të thjeshtuar midis të tjerash në përgjigje shkruhet:

3.4 Përshkruani arsytet ekonomike të përqendrimit.

Privatizimi I HEC Ulëz Shkop është miratuar me ligj të veçantë nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë. Kurum International ishte ofertuesi i cili ofroi çmimin më të lartë për aksionet në shitje dhe si i tillë fitoi mundësinë e realizimit të këtij përqendrimi. Në bazë të Kontratës së Shitblerjes, Shoqëria Target do të ketë të drejtë të zgjidhë kontratën e furnizimit të KESH me energji në se dëshiron.

3.5 Përshkruani dhe argumentoni përfitimet që rezultojnë për konsumatorin pas realizimit të përqendrimit , në mënyrë të veçantë

- (a) Rënien e çmimeve;
- (b) Rritjen e cilësisë së produkteve/shërbimeve
- (c) Inovacionet teknologjike;
- (d) Rritjen e mundësisë së zgjedhjeve për konsumatorët.

Përgjigja:

Siç dihet, tregu I energjisë elektrike është një treg I rregulluar I monitoruar ngushtë nga ERE dhe pavarësisht këtij privatizimi, aktiviteti I prodhimit e shitjes së energjisë nga Shoqëria target pas ndryshimit të kontrollit do të mbikqyret dhe monitorohet nga ERE në kuadër të funksionimit të saj në përputhje me Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 338, date 09.03.2008, të ndryshuar dhe mbrojtjes së interesve të konsumatorit .

Nuk është vështirë të konstatohet se përgjigja në formular lidhur me pikën 3.5 të Formularit të Thjeshtuar të Përqëndrimit e sidomos me nënçështjen (a) nuk është dhënë ,

Kjo në një kohë kur, pyetja nr.5 e kryer nga Sekretariati ka qënë e drejpërdrejtë : lutem te na vini ne dispozicion nje informacion plotesues si me poshte : 5. Sqarimi i justifikimit ekonomik dhe eficensat pas realizimit te ketij transaksioni(perqendrimi).

6. Sasia vlera dhe burimi i importit te energjise elektrike nga shoqeria Kurum International Sh.a per vitin 2012;

Ndërkohë për sa më sipër Grupi i punës që ka hartuar Raportet e këtyre përqëndrimeve, ka realizuar një punë të përciptë, duke përcjelle vetëm atë që ka përshkruar firma njoftuese dhe duke përjashtuar analizen ekonomike dhe ate qe eshte kerkuar : 5. Sqarimi i justifikimit ekonomik dhe eficensat pas realizimit te ketij transaksioni(perqendrimi).

Në këto rrethana lind pyetja a mjafton vetem praktika Copy Past e grupit të Punës pa analizen përkatëse ekonomike ?!. **Unë mendoj se Jo.**

Dhe here tjetër nuk jam pajtuar me këtë praktikë të përsëritur të Grupit të Punës gjatë shqyrtimit të përqëndrimeve. Zbatimi i ligjit dhe akteve të tij nënligjore, kërkesat konkrete të Formularit të Përqëndrimit kërkojnë analizën dhe vlerësimin e qartë lidhur me kërkesat e Formularit

Këtu dua të evidentoj nga ndermarrja blerëse Kurum janë dërguar të gjitha dokumentat e kerkuara mbi bazën e Ligjit, nga Autoriteti i Konkurrencës si dhe është dërguar dokumeti :” **INFORMACION NË LIDHJE ME PËRFITIMIN E KONTROLLIT TË HEC ULËZ SHKOPET DHE HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2 SH.A NGA KURUM INTERNATIONAL SH.A** “, informacion që mundëson t’l përgjigjesh në mënyrë objektive, të plotë dhe të saktë kërkesave të Formularit të Përqëndrimit .

Për rrjedhojë në thelb për gjykimin dhe vlerësim tim Unë nuk kam asnje pretendim KUNDER me palën blerëse të përqëndrimit/transaksionit e cila është treguar korrekte me Autoritetin e Konkurrencës konform ligjit.

Qëndrimi im KUNDER lidhet me mosplotësimin e plotë dhe të saktë nga firma njoftuese KALO & ASSOCOATES dhe moskryerjen e analizës përkatëse ekonomike nga Hartuesit e Raportit të Përqëndrimit .

Mbështetur në informacionin që ekziston në dosjet përkatëse rezulton **ndryshimi** i a) Licensës të tregëtimit të energjisë elektrike të prodhuar nga Hidrocentralet e Ulëz Shkopetit dhe Bistrica nr 1 dhe 2; b) ndryshimi i tarifave përkatse që burojnë nga ndryshimi i këtij statusi.

Le të shohim ne fillim se cilat jane efektet e ndryshimit te Licenses se tregëtimit të tregëtimit te energjisë elektrike të prodhuar nga Hec Ulëz-Shkopet dhe Bistrica nr 1 dhe 2 ?

Kalimi nga licensa paraprivatizimit për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike nga Hec Ulëz Shkopet, dhe Bistrica nr 1 dhe 2 në licensen e re LICENSIMIN E SHOQËRISË “KURUM ENERGY” SH.A në AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE

KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE, do të thotë se Shoqëritë target do të kenë të drejtën të zgjidhin kontratën e furnizimit të Furnizuesin Publik me Shumicë (KESH) me energji në se deshiron. Kjo do të thotë se në se interes e tyre kërkojnë që energjia elektrike të eksportohet atehere ajo do eksportohet pa furnizuar Furnizuesin Publik me Shumicë. Kjo nuk është një mundësi Potenciale por reale po te mbahet parasysh se prodhimi total I shoqerive target per vitin 2012 ishte për shoqerinë Kurum _258.2 Gwh, në një kohë kur prodhimi i HEC Ulëz Skopet dhe Bistria 1 dhe 2 ishte 397.9 Gwh . Pra tepricen e konsumit mbi prodhimin mund te ekportohet Kjo mund te ndodhe ne se çmimi i eksportit eshte me I larte se ai qe mund ta blejne konsumatorët vendas. Një situatë e tillë mund të ndodhe megjithse ekonomia shqiptare është në përgjithësi (veç rasteve të prodhimit maksimal të energjise elektrike) importuese neto e energjisë elektrike.

Ndërkohe është e njohur diferenca e madhe e çmimit të shitjes nga HEC-et e Ulëz Shkopetit dhe Bistrica nr 1 dhe 2 që ishin për vitin 2012 që sipas të dhenave te prezantuara nga KURUM ishin respektivisht,

Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Bistrica 1, 2 sh.a për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 - 2014), do të jetë 2.2 leke/kWh.

Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Ulëz Shkopet sh.a për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 - 2014), do të jetë 2.72 leke/kWh.

Per vitin 2012 ndermarrja Kurum , ka Konsumuar 258.2Gwh me një çmim blerje prej ?(ky informacion mungon kur pyetja ka qënë e drejperdrejtë për të. Megjithatë dihet se Kurum si klient jo tarifor është furnizuar për vitin 2012 me çmime të dereguluara.

Në keto rrethana Kurumit si konsumatore e energjise elektrike si konsumator I kualifikuar I bëhet mirë, por kjo në dem te konsumatorve tarifore(Furnizuesit Publik me Shumicë) I cili sasine që blinte deri para shitjes të Ulëz Shkopetit dhe Bistrica 1 dhe 2 nga keto hidrocentrale do I duhet ta bleje nga furnizuesit e kualifikuar, HEC private ose me Koncesion ose nga Importi me një çmim disa fish më të lartë.

Ne se I hidhet nje sy nje sy energjise se blere nga FPSH per vitin 2012, rezulton se jane blere me çmime tregu 880,775 milion kwh me cmime tregu, . Kjo do të thotë se per të plotesuar detyrimet e Veta FPSH do të heqë dore nga blerja e e Energjise elektrike me çmimet e mësipërme që e blinte nga HEC e Bistrises dhe Ulzë Shkopetit dhe do e blere ato me çmime tregu.

Pra nuk kemi nje realizim të efiçences Pareto. Ky perqendrim ka nje efekt negative ne renien e efiçences se gjenerimit dhe tregimit të energjise elektrike, për tregun tarifor duke dëmtuar dukshëm interesat dhe në dëm të konsumatorve tarifore. Pra, duke dëmtuar hapur kërkesat e konsumatorit.

Këto duhet të ishin pasqyruar edhe në Formularin e Theshtuar të Perqendrimit. Por pavaresisht si ka operuar Firma njoftuese Kalo, ky qëndrim nuk duhej të ishte anashkaluar dhe anashkalohet nga Sekretariati, duke rënë në pozitat e Regulatory Capture.

Fryma dhe Gërma e Formularit të Përqendrimit është e qarte, të mos dëmtohet konkurrenca, të mos dëmtohet konsumatori.

Lidhur me Pyetjen e dytë të permendur ne fund te faqes 5, në thelb nuk mora pëgjigje . Kjo çështje nuk është trajtuar nga Sekretariati dhe as nga Raporti i Grupit të Punës.

Ne fakt shitblerja e Hidrocentraleve Ulëz Shkopet dhe Bistrica nr 1 dhe 2 janë bërë mbi bazen e bilanceve te vitit 2011 të cilat në fakt nuk janë bilance vjetore por vetëm për periudhën 01.09.2011-31.12.2011 me të cilat nuk krijohet nje informacion I plotë I nevojshem per gjithë pjesmarrsit qe marrën pjesë ne shitblerjen e Hec-eve

Ndërkohë është e njohur se sipas Ligjit mbi të Ardhurat neni mbi “Amortizimin” shprehet qartë se llogaritja e amortizimit mbështet në “3. Kostot e blerjes ose të ndertimit, kostot e permirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndertesave, të konstruksioneve dhe makinerive e paisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas , me vlerën e mbetur , me 5 %.”

Në Pasqyrat Financiare për vitin 2011, të HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sha, lidhur me Amortizimin thuhet:

Amortizmi llogaritet në menyrë lineare mbi jetën e dobishme të aktiveve si më poshtë:

Ndërtesat 67-100 vite

Të tjera ndertime 60-65 vite

Makineri dhe Paisje 10-45 vite

Mjete transporti 5 Vite

Mobilje e orendi dhe

Paisje kompjuterike 4 vite.

Në këtë kushte kur vetëm kalimi nga një metode e normë llogarritje të amortizimit në një tjetër, sjell efekte prej dhjetra qindra milionë lekë bëra pyetjen e siper përmendur për t’u njohur në se jemi para realizimit të një konkurrence të lirë efektive të ndershme apo Jo ?!

Në mungesë analizës nga ana e Stafit të Sekretariatit (Grupit të Punës) e të dhënies se Përgjigjes për pyetjen e bërë,në kushtet kur ndryshimet ne noramt e mesiperme tee amortizimit shprehin shenja për kufizimin e shtrembërimin e mundshëm të konkurrencës në këtë treg, i bindur mbi efektet që ka ky aspekt (amortizmi dhe metodat dhe llogarritjet konkrete) në konkurrencen e lirë dhe efektive nuk mund të jem pro Autorizimit të Përqëndrimit .

Për rrjedhojë duke u nisuar nga sa më sipër unë nuk jam dakort me Raportin e konkluzionet e Grupit të Punës nuk e aprovoj Autorizimin e ketij Perqendrim dhe per rrjedhojë kam dhënë votën KUNDËR .

Komisioner

Koço Broka